

Vendim i Këshillit të Ministrave nr.463, date 05.07.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.”

3.15 ENERGJIA

3.15.1 SEKTORI I ENERGJISË

1. Objektivi politik i fushës

Hapja reale e tregut të energjisë mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare në këtë fushë, prioritet ky që bëhet edhe më i detyrueshëm pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit për Energjinë. Synimi kryesor do të jetë integrimi në tregun rajonal të energjisë elektrike. Hapja e këtij tregu do të nxisë tërheqjen e kapitaleve private dhe rritjen e ndjeshme të kapaciteteve prodhuese dhe furnizuese të sistemit elektroenergjitik shqiptar.

Në funksion të realizimit të këtij objekti, në periudhën afatshkurtër do të zbatohet procesi për rikonstruktimin e privatizimin e KESH.

Fillimisht, do të kryhet ndarja në shoqëri të veçanta e veprimtarive të KESH si prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike.

Gjithashtu, do të rriten kapacitetet rregullatore të Entit Rregullator i Energjisë, me qëllim që të jetë në gjendje që të luajë rolin e arbitrit të paanshëm në tregun e liberalizuar të energjisë.

Objektiv afatmesëm do të jetë harmonizimi i gjithë kuadrit ligjor me *acquis communitaire*, në mënyrë që tregu shqiptar i energjisë t'i përafrohet stndarteve dhe normave europiane. Objektivi tjetër afatmesëm është mbështetja e integritit të Shqipërisë në rreketin e transmetimit rajonal dhe european të energjisë së të gjitha llojeve.

2. Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Veprimtaria e funksionimit dhe kontrollit të energjisë në Republikën e Shqipërisë rregullohet nepernjete ketyre akteve kryesore ligjore dhe nenligjore:

- Ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006 "Për ratifikimin e traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë";
- Ligji nr. 9379, datë 28.04.2005 "Për Eficiencën e Energjisë", i cili nxit përdorimin me eficiencë të të gjitha llojeve të energjisë;
- Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 "Mbi sektorin e energjisë elektrike", i cili përcakton kushtet për furnizimin me energji elektrike të konsumatoreve, në përputhje me parametrat standarte, përmes funksionimit të efektshëm të tregut të energjisë dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke marre parasysh ruajtjen e interesave të konsumatorit, minimizimin e kostove të shërbimeve dhe respektimin e mjedisit. Ky ligj ka një nivel përputhshmërie "të plotë" me Direktivën 2003/53/EC;
- Ligji nr. 8937 datë 12.09.2002 "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa", i cili përcakton vendosjen e rregullave dhe bërjen e detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.
- VKM nr. 539, datë 12.08.2004 "Për aprovimin e modelit tranzitor të tregut të energjisë elektrike", i cili është bazuar në zbatimin gradual të Direktivave 96/92/EC dhe 2003/54/EC;

Në zbatim të legjislationit bazë, ERE ka miratur Kodin e Shpërndarjes, të Matjes, të Transmetimit dhe Rregullat e tregut.